

## Kapitulli i Katërt

# Pasqyrat financiare të Bankës së Shqipërisë

### 4.1. BILANCI PËRMBLEDHËS I BANKËS SË SHQIPËRISË

AKTIVET		1999
	Shënim nr.	Lekë (milionë)
<b>Aktive të huaja</b>		
Ari	3	977
Depozita tek Fondi Monetar Ndërkombëtar	4	21,559
Depozita në bankat e huaja	5	41,382
Letra me vlerë	6	13,791
Aktive të tjera të huaja	7	431
<b>Totali i aktiveve të huaja</b>		<b>78,140</b>
<b>Aktive vendase</b>		
Kredi tranzite	8	6,686
Kredi ndaj qeverisë	9	32,258
Investime në letra me vlerë	10	40,938
Aktive të tjera vendase	11	2,315
<b>Totali aktiveve vendase</b>		<b>82,197</b>
<b>Totali i aktiveve</b>		<b>160,337</b>

<b>DETYRIMET</b>		
<b>Detyrime të huaja</b>		
Detyrime ndaj Fondit Monetar Ndërkombëtar	12	21,434
Detyrime ndaj institucioneve financiare jovendase	13	8,118
Detyrime të tjera të huaja		19
<b>Totali i detyrimeve të huaja</b>		<b>29,571</b>
<b>Detyrime vendase</b>		
Para në qarkullim	14	82,946
Detyrime ndaj bankave vendase	15	27,137
Detyrime ndaj qeverisë	16	3,559
Detyrime të tjera vendase		67
<b>Totali i detyrimeve vendase</b>		<b>113,709</b>
<b>KAPITALI I VET</b>		
Kapitali themeltar		750
Rezerva ligjore		3,750
Rezerva e rivlerësimit		2,917
Rezerva të tjera		7,407
Fitimi i mbartur		2,233
<b>Totali i kapitalit të vet</b>		<b>17,057</b>
<b>Totali i detyrimeve dhe kapitali i vet</b>		<b>160,337</b>

*Shënimet mbi pasqyrat financiare janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.*

## 4.2. PASQYRA E REZULTATIT FINANCIAR

		1999
	Shënim nr.	Lekë (milionë)
<b>Shërbime ndaj jorezidentëve</b>		
Të ardhura nga interesa dhe komisione		2,381
<b>Shpenzime interesi dhe komisioni</b>		359
<b>Totali neto i interesave dhe komisioneve nga shërbimet ndaj jorezidentëve</b>		<b>2,022</b>
<b>Shërbime ndaj rezidentëve</b>		
Të ardhura nga interesa dhe komisione		15,105
Të ardhura operative të tjera, neto	17	18
<b>Totali neto i të ardhurave operative</b>		<b>17,145</b>
<b>Shpenzime të tjera jooperative</b>		
Shpenzime personeli	18	142
Shpenzime amortizimi		66
Shpenzime amortizimi të shtypjes dhe prerjes së parasë		244
Shpenzime të përgjithshme dhe administrative		48
Shpenzime të tjera		50
<b>Totali i shpenzimeve të tjera jooperative</b>		<b>550</b>
<b>FITIMI NETO</b>		<b>16,595</b>

*Shënimet mbi pasqyrat financiare janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.*

### 4.3. PASQYRA E NDRYSHIMIT TË KAPITALIT

Lekë (milionë)	Kapitali themeltar	Rezerva ligjore	Rezerva e rivlerësimit	Rezerva të tjera	Fitimi i pashpërndarë	Totali
Sipas 31 dhjetorit 1998 (e paaudituar)	750	3,750	6,906	7,223	2,233	20,862
Fitimi neto	-	-	-	-	16,595	16,595
Rivlerësimi i valutave të huaja dhe arit	-	-	(3,989)	-	-	(3,989)
Shpërndarja e fitimit	-	-	-	184	(16,595)	(16,411)
<b>31 dhjetor 1999</b>	<b>750</b>	<b>3,750</b>	<b>2,917</b>	<b>7,407</b>	<b>2,233</b>	<b>17,057</b>

*Shënimet mbi pasqyrat financiare janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.*

#### 4.4. INFORMACIONE TË PËRGJITHSHME

Banka e Shqipërisë është banka qendrore e Republikës së Shqipërisë dhe u themelua sipas ligjit “Mbi Bankën e Shqipërisë” më 1992. Sipas termave të këtij akti përgjegjësitë kryesore të bankës janë:

- \* vendosja dhe ruajtja e stabilitetit të çmimeve;
- \* mbështetja e zhvillimit të një regjimi të këmbimeve valutore;
- \* menaxhimi i parasë në qarkullim;
- \* menaxhimi i normave të interesit;
- \* parashkimi dhe analiza e treguesve të zhvillimeve ekonomike dhe sociale brenda Republikës së Shqipërisë;
- \* mbikëqyrja e aktiviteteve të bankave të nivelit të dytë, përfshirë dhënien e licencave për të gjitha bankat;
- \* dhënia e licencave për ushtrimin e aktivitetit brenda territorit të Republikës së Shqipërisë të institucioneve bankare ndërkombëtare.

Banka i nënshtrohet rregulloreve të hartuara nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë dhe ligjit të Bankës së Shqipërisë.

#### 4.5. PËRMBLEDHJE E DISA PARIMEVE TË RËNDËSISHME KONTABËL

Pasqyrat financiare përgatiten në përputhje me ligjin “Për Kontabilitetin”. Parimet Ndërkombëtare të Kontabilitetit janë aplikuar vetëm në rastet kur është parë e arsyeshme.

Parimet kontabël më të rëndësishme të përdorura nga banka në përgatitjen e pasqyrave financiare jepen të detajuara më poshtë.

##### 4.5.1 Bazat e paraqitjes së pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare të paraqitura përfshijnë llogaritë e bankës përgatitur mbi bazën e parimit të kostos historike të modifikuar duke përfshirë rivlerësimin e valutave të huaja dhe të arit.

Pasqyrat financiare paraqiten në monedhën vendase të Republikës së Shqipërisë, Lek shqiptar (Lekë).

##### 4.5.2 Interesa dhe komisione.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare të ardhurat dhe shpenzimet nga interesa regjistrohen sipas kontabilitetit të të drejtave të konstatuara.

Të ardhura nga komisione regjistrohen kur të ardhurat janë marrë.

Shpenzime komisioni regjistrohen kur shpenzimet janë paguar.

##### 4.5.3 Konvertimi i valutave të huaja.

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në Lekë me kursin zyrtar të këmbimit të bankës në datën e kryerjes së transaksionit.

Aktivët dhe pasivët në monedhë të huaj konvertohen në Lekë me kursin zyrtar të këmbimit të bankës në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga kursi i këmbimit kreditohen ose debitohen tek llogaria rivlerësimi i rezervës.

Kursi zyrtar i këmbimit i aplikuar nga banka (njësi e monedhës së huaj përkatëse e shprehur në Lekë) për monedhat e huaja më kryesore më 31 dhjetor 1999 paraqitet si më poshtë:

	<b>1999</b>
Dollari Amerikan (“USD”)	135.12
Marka Gjermane (“DEM”)	69.43
Lireta Italiane (“ITL”)	0.07
Monedha Europiane (“Euro”)	135.80
Sterlina Angleze (“GBP”)	218.22
Franga Zvicerane (“SFR”)	84.66
Të drejta të veçanta tërheqjeje (“SDR”)	185.25

#### 4.5.4 Investimet.

Bonot e thesarit për mbulimin e buxhetit të shtetit shprehen me çmimin e blerjes plus skonton e amortizuar. Bonot e thesarit të shtetit amerikan dhe bonot e thesarit afatshkurtër shprehen me vlerën e tregut.

#### 4.5.5 Marrëveshjet e riblerjes.

Letrat me vlerë të blera me marrëveshje riblerjeje konsiderohen si hua e kolateralizuar.

#### 4.5.6 Aktivet e qëndrueshme.

Aktivitet e qëndrueshme shprehen me koston historike të zvogëluar me amortizimin e akumuluar.

Në qoftë se vlera e tregut e një aktivi të qëndrueshëm është më e vogël sesa vlera kontabël, për shkak të rrethanave të konsideruara jo të përkohshme, aktivi hiqet me vlerën e tregut.

Fitimet ose humbjet nga heqja e aktiveve të qëndrueshme regjistrohen në llogarine humbje-fitim të vitit në të cilin aktivi është hequr.

Amortizimi llogaritet mbi të gjitha aktivet fikse bazuar në koston historike. Amortizimi vjetor llogaritet me metodën lineare duke përdorur normat specifike të amortizimit për çdo aktiv të amortizueshëm bazuar në jetën e përdorimit të vlerësuar. Jetët e vlerësuara të aplikuara janë:

<b>Ndërtesat</b>	33 vjet
Mjete transporti	5 vjet
Pajisje zyre	10 vjet
Programe kompjuteri	3 vjet

#### 4.5.7 Kosto të shtypjes dhe të prerjes së parasë.

Kostot e printimit të kartëmonedhave dhe prerjes së monedhave kapitalizohen dhe amortizohen respektivisht për mbi dy dhe dhjetë vjet.

#### 4.5.8 Tatimi dhe shpërndarja e fitimit.

Banka është e përjashtuar nga tatimi mbi fitimin në bazë të ligjit "Mbi Bankën e Shqipërisë" dhe kërkohet me ligj që 100 për qind e fitimit të kalojë direkt në buxhetin e shtetit pas plotësimit të niveleve të fondeve rezervë të kërkuara nga Këshilli Mbikëqyrës.

#### 4.5.8 Rezerva ligjore.

Në përputhje me legjislacionin bankar shqiptar, banka ka krijuar një rezervë ligjore në të cilën, 25 për qind e fitimit neto të vitit transferohet derisa shuma e rezervës arrin 500 për qind të kapitalit të nënshkruar.

#### **4.5.9 Përdorimi i parashikimeve.**

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon nga drejtimi i bankës që të bëhen parashikime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve dhe pasiveve dhe paraqitjen e aktiveve dhe detyrimeve llogaritur për ngjarje të paparashikuara me datën e përgatitjes së këtyre pasqyrave financiare dhe shumat e raportuara të të ardhurave dhe shpenzimeve gjatë periudhës së raportuar. Ky parashikim bëhet sepse rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga ato të parashikuara.

#### **4.5.10 Aktive të menaxhuara.**

Më 31 dhjetor 1999, banka mban në kujdestari bono thesari afatshkurtra të emetuara nga Ministria e Financave, me një shumë 139,700 milionë lekë. Meqë banka luan rolin e një kujdestari për këto letra me vlerë, ajo nuk ka asnjë lloj risku krediti.

Banka, gjithashtu, administron ar dhe metale të tjera të çmuara në emër të qeverisë. Vlera e arit dhe e metaleve të çmuara sipas 31 dhjetorit 1999 arrin një shumë prej 3,834 milionë lekësh, të vlerësuara me kursin e këmbimit fiks të Londrës në datën e bilancit.

Këto aktive janë përjashtuar nga bilanci i bankës.



## 4.6. AKTIVET

### 4.6.1 Ari

Sipas 31 dhjetorit 1999, vlera e rezervave të arit, pronë e Bankës së Shqipërisë, është 641 milionë lekë. Banka posedon 16,302.056 onz ar të vendosura në depozita ari me afat, ndërsa ari monetar i bankës në kasafortë është 8,007.88 onz ar me një vlerë prej 336 milionë lekësh.

Ari është vlerësuar me kursin e këmbimit fiks të Londrës në datën e bilancit. Diferencat që rezultojnë nga rivlerësimi i arit janë regjistruar në rezervën e rivlerësimit. Më 31 dhjetor 1999, një onz ar u vlerësua me 290.85 dollarë amerikanë.

### 4.6.2 Depozita të Fondit Monetar Ndërkombëtar

Më 31 dhjetor 1999, në milionë lekë, në depozitat e Fondit Monetar Ndërkombëtar përfshihen:

Fondi Monetar Ndërkombëtar	11,173
SDR	10,386
<b>Totali</b>	<b>21,559</b>

Të arkëtueshmet nga FMN-ja rezultojnë prej anëtarësisë së Republikës së Shqipërisë në FMN dhe kjo shumë është e garantuar me një notë premtimi emetuar nga qeveria. Depozitat në SDR janë të barabarta me kuotën e anëtarësisë së Republikës së Shqipërisë paguar FMN-së në SDR dhe në Lekë, e cila ka si kundërparti huatë e dhëna nga FMN, Republikës së Shqipërisë siç paraqitet në shënimin 12.

### 4.6.3 Depozita në bankat e huaja

Sipas 31 dhjetorit 1999, në milionë lekë, depozitat në bankat e huaja përbëhen nga:

Llogari rrjedhëse	9,688
Depozita afatshkurtra	31,694
<b>Totali</b>	<b>41,382</b>

Depozitat në bankat e huaja shprehen kryesisht në dollarë amerikanë dhe marka gjermane.

#### 4.6.4 Letrat me vlerë

Më 31 dhjetor 1999, në milionë lekë, në letrat me vlerë përfshihen:

Bono thesari të Qeverisë Amerikane	13,158
Investime të tjera	633
<b>Totali</b>	<b>13,791</b>

Maturimi i bonove të thesarit të Qeverisë Amerikane varion midis marsit dhe dhjetorit të vitit 2000 dhe nuk sjell interes.

Zëri "Investime të tjera" përfshin pjesëmarrjen në Bankën Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), në Bankën Botërore dhe në Grupin e Bankës Botërore.

#### 4.6.5 Aktive të tjera të huaja

Sipas 31 dhjetorit 1999, aktive të tjera të huaja përbëhen nga arka në valutë me një vlerë 206 milionë lekë dhe interesi i përlogaritur mbi depozitat në bankat e huaja me një vlerë prej 225 milionë lekësh.

#### 4.6.6 Kredi Tranzite

Kreditë tranzite, në milionë lekë, sipas sektorëve të industrisë, ndahen si më poshtë:

Bujqësi	1,437
Industri	4,245
Sektori i shërbimeve dhe të tjera	1,004
<b>Totali</b>	<b>6,686</b>

Kreditë tranzite përfaqësojnë shërbime krediti pa interes, akorduar institucioneve të kreditit, për t'iu shpërndarë huamarrësve me qëllim mbështetjeje të programeve qeveritare të zhvillimit. Të gjitha huatë janë të garantuara nga Qeveria Shqiptare.

#### 4.6.7 Kredi ndaj qeverisë

Sipas 31 dhjetorit 1999, totali i kredisë ndaj qeverisë është 32,258 milionë lekë, nga të cilat për totalin 22,829 milionë lekë merret interes me një normë mesatare prej 5.5 për qind për vitin 1999, ndërsa 9,429 milionë lekë janë pa interes.

#### 4.6.8 Investime në letra me vlerë - vendase

Më 31 dhjetor 1999, në milionë lekë, investimet në letrat me vlerë përbëhen nga:

Bono thesari për mbulimin e buxhetit të shtetit	24,592
Bono thesari afatshkurtra	13,240
Letrat me vlerë për kooperativat	1,958
Letra me vlerë për kapitalizimin e Bankës Kombëtare Tregtare	1,148
<b>Totali</b>	<b>40,938</b>

Bonot e thesarit për mbulimin e buxhetit të shtetit i përkasin kredive të dhëna qeverisë prej vitit 1994 deri në vitin 1999, një pjesë e të cilave është shndërruar në bono. Interesi është vendosur për gjashtë muaj i bazuar në normat e skontos për bonot e thesarit afatshkurtra, të cilat aktualisht variojnë nga 15.4 për qind në 19.5 për qind. Maturiteti për këto bono është gjashtë muaj.

Letrat me vlerë për kooperativat kanë lidhje me një kredi ndaj kooperativave bujqësore shtetërore para vitit 1992. Qeveria ka emetuar letra me vlerë me shumën e kredisë. Këto letra me vlerë fitojnë një normë interesi prej 1.5 për qind.

Letrat me vlerë për kapitalizimin e Bankës Kombëtare Tregtare kanë të bëjnë me obligacione zero kupon, të cilat janë lëshuar nga qeveria për të zëvendësuar pjesëmarrjen në kapital në Bankën Kombëtare Tregtare. Letrat me vlerë fitojnë një interes prej 6 për qind në vit dhe maturohen në vitin 2006.

#### 4.6.9 Aktive të tjera vendase

Më 31 dhjetor 1999, në milionë lekë, në aktive të tjera vendase përfshihen:

Interes i përllogaritur	1,027
Debitorë të tjerë	352
Kredi punonjësve	350
Aktive fikse neto	292
Ar dhe Argjend në kasafortë	37
Inventari	13
Të tjera	244
<b>Totali</b>	<b>2,315</b>

Më 31 dhjetor 1999, në milionë lekë, vlera kontabile neto e aktiveve të qëndrueshme sipas kategorive përfshin:

Aktive të tjera të qëndrueshme	278
Ndërtesat	125
Mjete transporti	94
Aktive në proces	6
	503
	<hr/>
Amortizim i akumuluar	-211
	<hr/>
<b>Totali</b>	<b>292</b>

Bazuar në ligjin shqiptar, titulli ligjor i ndërtesave të bankës është i paqartë. Menaxhimi është i mendimit se kjo çështje do të zgjidhet me Ministrinë e Financave, në një të

## 4.7. PASIVET

### 4.7.1 Detyrime ndaj fondit monetar ndërkombëtar

Më 31 dhjetor 1999, në milionë lekë, detyrimi ndaj Fondit Monetar Ndërkombëtar përbëhet nga:

Shërbime Ndihmëse për Rregullime Strukturale ("ESAF")	10,882
Letra me vlerë tek FMN	8,727
Llogari e FMN-së në Lekë	1,825

**Totali** **21,434**

Huatë e ESAF-it janë të lidhura me kuotizacionin e Republikës së Shqipërisë në FMN dhe maturohen nga viti 2003 deri në vitin 2005. Huatë e ESAF-it nga FMN janë tërhequr në emër të qeverisë për reformat makroekonomike.

### 4.7.2 Detyrimi ndaj institucioneve financiare jovendase

Detyrimi ndaj institucioneve financiare jovendase, në milionë lekë, përfshin:

Hua për zhvillim (shënimi 8)	6,689
Hua e Bankës së Greqisë	1,237
Detyrim ndaj Bankës Botërore	192

**Totali** **8,118**

Huaja për zhvillim është dhënë nga Kreditanstalt fur Wiederaufbau (6,032 milionë lekë) dhe Banka Europiane e Investimeve (657 milionë lekë). Interesi paguhet nga bankat dhe kompanitë vendase drejtpërsëdrejti ndaj investitorëve.

Huaja e Bankës së Greqisë (hua e Republikës Greke) është dhënë me qëllim të financimit të bilancit të pagesave të Republikës së Shqipërisë. Norma e interesit është caktuar 4 për qind në vit, dhe është e pagueshme çdo 6 muaj. Huaja maturohet në 2018.

### 4.7.3 Paraja në qarkullim

Banka ka të drejtën ekskluzive të emetimit të monedhës kombëtare. Ky zë përfshin kartëmonedha dhe monedha vendase në qarkullim të emetuara nga banka.

Më 31 dhjetor 1999, në milionë lekë, struktura e mëposhtme e monedhave dhe e kartëmonedhave që ishin në qarkullim:

Vlera nominale Lekë	Numri Në mijë	Vlera Lekë (milionë)
1	21,016	21
3	6,489	20
5	6,373	32
10	7,684	77
50	749	38
100	17,831	1,783
200	27,706	5,541
500	64,048	32,024
1,000	40,298	40,298
5,000	476	2,380
Monedha		732
<b>Totali</b>		<b>82,946</b>

### 4.7.4 Detyrime ndaj bankave vendase

Më 31 dhjetor 1999, në milionë lekë, detyrimi ndaj bankave vendase përfshin:

#### Në monedha të huaja

Llogari të bankave të nivelit të dytë	84
Rezervë e detyrueshme e bankave të nivelit të dytë	5,684
	<b>5,768</b>

#### Në lekë

Llogari të bankave të nivelit të dytë	20,584
Bono thesari shitur me marrëveshje riblerjeje	785
	<b>21,369</b>

<b>Totali</b>	<b>27,137</b>
---------------	---------------

Banka nuk paguan interes për llogari rrjedhëse dhe rezervë të detyrueshme të bankave vendase.

#### 4.7.5 Detyrimi ndaj Qeverisë

Më 31 dhjetor 1999, në milionë lekë, detyrimi ndaj qeverisë përfshinte:

Depozita në emër të qeverisë	1,562
Fitimi për t'u dhënë qeverisë	1,903
Të tjera	94
<b>Totali</b>	<b>3,559</b>

#### 4.7.6 Të ardhura të tjera operative, neto

Të ardhura të tjera operative, në milionë lekë, përfshin:

Humbje neto nga shitja e investimeve	-1
E ardhur neto nga tregtimi i monedhave të huaja dhe metaleve të çmuara	3
Të ardhura të tjera	16
<b>Totali</b>	<b>18</b>

#### 4.7.7 Shpenzime të personelit

Shpenzime të personelit përfshijnë pagat e personelit, shpenzimet sociale dhe shpenzime të tjera. Shpenzimet sociale përfaqësojnë kryesisht kontributin e detyrueshëm ndaj Fondit të Sigurimeve Shoqërore, Fondit Shtetëror të Punësimin dhe shpenzime të tjera. Më 31 dhjetor 1999, banka ka patur 314 vende pune të miratuara nga të cilat 272 janë të plotësuar, duke përfshirë punonjësit e bankës, të degëve dhe të shtypshkronjës.

#### 4.7.8 Angazhime për ngjarje të paparashikuara

Banka është e përfshirë në një numër çështjesh gjyqësore dhe procedurash ligjore të ngritura gjatë aktivitetit të zakonshëm të biznesit. Drejtimi është i mendimit se këto procedura nuk do të kenë një efekt material në pozicionin financiar apo në rezultatet operative të bankës.

Nuk ka angazhime të tjera të rëndësishme për ngjarje të paparashikuara.

#### 4.7.9 Gjendje të periudhave të mëparshme

Tepriçat e periudhave të mëparshme nuk janë paraqitur, sepse ato janë përgatitur sipas standardeve shqiptare të kontabilitetit, të cilat ndryshojnë dukshëm nga standardet ndërkombëtare të kontabilitetit. Drejtimi beson se nuk do të ishte praktike paraqitja e informacionit krahasues në pasqyrat financiare të vitit që ka mbaruar më 31 dhjetor 1999.

#### 4.8. RAPORTI I AUDITORËVE TË PAVARUR

##### **Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë:**

Ne kemi audituar bilancin e Bankës së Shqipërisë ("Banka") më 31 dhjetor 1999. Ne, gjithashtu, na u kërkua të auditonim dhe pasqyrat e lidhura me to si pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve dhe pasqyrën e ndryshimeve në kapitalin e vet më 31 dhjetor 1999. Drejtimi i Bankës është përgjegjës për përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare. Përgjegjësia jonë është të japim opinion mbi këto pasqyra në përfundim të auditimit tonë.

Përveç sa diskutohet në paragrafin mëposhtëm, ne drejtuam auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne të planifikojmë dhe të zbatojmë procedurat e auditimit për të dhënë një siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare janë pa gabime materiale. Auditimi, bazuar mbi kryerjen e testeve, ka të bëjë me ekzaminimin e dokumentave në mbështetje të shifrave dhe informacioneve të tjera paraqitur në pasqyrat financiare. Auditimi, gjithashtu, vlerëson parimet kontabël të përdorura dhe parashkimet e bëra nga drejtimi, si dhe jep një opinion të përgjithshëm mbi paraqitjen e pasqyrave financiare. Ne besojmë se auditimi ynë ofron baza të arsyeshme për dhënien e opinionit.

Ne nuk kryem auditimin e bilancit më 31 dhjetor 1998 sepse kjo datë ishte para angazhimit tonë si auditorë, rregullime të cilat mund të kenë ndikim material në përpilimin e pasqyrës së të ardhurave dhe shpenzimeve më 31 dhjetor 1999, ndaj, ne nuk jemi në gjendje dhe nuk shprehim opinion mbi pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve dhe pasqyrën e ndryshimeve të kapitalit të vet më 31 dhjetor 1999.

Sipas opinionit tonë, bilanci prezanton, në të gjitha aspektet materiale, në mënyrë të drejtë pozicionin financiar të Bankës më 31 dhjetor 1999 në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit ("IAS") të përshtatura për politikën përgjithësisht të pranuar të kontabilitetit të aplikueshme për bankat qendrore.

Deloitte & Touche, Sh.p.k.

Tirana, Albania

31 mars, 2000